

Nuhi VESELAJ

CACE E HOPE DJALOSHARE
(në ide dhe në vargëzim)
(1948 - 1952)

Prishtinë, korrik 1986

P a r a t h ë n i e

Këto **CACËRIME** (përpjekje të para për gjetjen e rrugës në ide dhe në vargëzim) janë shkruar në periudhën 1948 - 1952, sa isha nxënës i Shkollës Normale të Gjakovës. Shumica prej tyre (zakonisht fragmentarisht) janë prezentuar, qoftë në orët e caktuara letrare që organizonte shkolla, qoftë duke i lexuar para shokëve, por edhe para të tjerëve, qoftë në "grupime", qoftë në ndeja të ndryshme etj. Shfrytëzoj rastin t'i shpreh falenderim mësuesit Hilmi Kryeziu (nga Gjakova), të cilit i pata dhënë mundimin që t'i lexonte dhe të jepte vërejtjet e rastit. Sugjerimet e tij kanë qenë shumë me vlerë për punën time të mëtejshme edhe për cacërime e hapërime të tjera në fushën e vargëzimit të ideve përkatëse.

Ç`është e vërteta, vlerësuesi i parë i shumicës prej tyre në versionin zanafillës ishte im at, i cili më nxiste t'ia lexoja jo vetëm atij por edhe në oda para xhaxhallarëve, kushërinjve si dhe mysafirëve të rastit. Asht e vërtetë se në mjaft raste kishte dorë jo vetëm ideja, por edhe ndonjë fjalë a shprehje e tij, ngase ishte pleqnar, kishte fjalë dhe nga mendja ishte i hollë.

Në nëntor të vitit 1952 kur rashë në burg, për të mos rënë në dorë të "organeve të hetuesisë" ime kunatë i kishte pasë fshehur duke i çuar në gjini, në fshatin Sllapuzhan të Suharekës.

Dorëshkrimi më ra në dorë pothuajse pas pesë-gjashtë vjetësh, pasi kisha dalë nga burgu dhe paksa pasi ishte qetësuar çështja. Ç`është e vërteta, meqenëse veprimtaria ime ishte në mbikëqyrje permanente, përsëri këto dorëshkrime (shumica) nuk ishin të lira të qarkullonin. Kjo është arsyeja që pos temave të caktuara dedikuar vjershave për fëmijë, materiali i tillë me përmbajtje serioze nuk mundi të shfrytëzohej as të adaptohej sheshazi. Prandaj mbeti ashtu i pa përpunuar në ndonjë farë mënyre deri në ditët e sotme. Arsyet dihen. Në rrethanat që kemi përjetuar vetëm ndonjëri nga dorëshkrimet do të mjaftonte që autori të persekutohej.

Pas ndryshimeve të fundit, tashti pas kaq vjetësh, ato i rimora në dorë dhe i rilexova. Për çudi, e them me rezervë, nuk m'u duken edhe aq të pa arrira e naive, qoftë nga pikëpamja e vargëzimit, qoftë nga pikëpamja mendimore e të shprehjeve të ideve si gjurmë të kohës, edhe pse tashti mjaft gjëra mund të shihen e të trajtohen në një prizëm tjetër dhe me mjete të tjera shprehëse.

Më ka befasuar fakti se mjaft vargje a fragmente nga këto "cacërime" edhe tash po i mbanin mend disa individë e sidomos ime motër që i kishte ndëgjuar që atëherë kur ishte fëmijë. Kam pasur raste që edhe ndonjëri nga shokët e shkollës të ma rikujtonte ndonjë varg a ide. Është e vërtetë se gjatë bisedave të lira dhe me nxënës shpesh herë kam recituar vargje apo i kam parafrazuar idetë e trajtuara në këto "vargëzime" të para, por gjithsesi duhej pasur kujdes që mos të pësonim.

Kështu që vetë fakti i ekzistimit të dorëshkrimeve të tilla më nxiti që tashti t'i rilexoj, më mirë me thënë, t'i rishikoj dhe t'i rishkruajë e përpunojë ndonjë fragment, por pa u bërë ndryshime të ndjeshme në përmbajtje. Madje nuk e pashë të arsyeshme të intervenoj plotësisht as nga pikëpamja gjuhësore, për t'i përshtatur sipas normës së shqipes së sotme letrare, sidomos disa nga trajtat a shprehjet e gegërishtes.

Edhe pse të gjitha temat (idetë) e trajtuara në këtë përmbledhje pasqyrojnë kohën e "andolëshencës politike" kur u shkruan si dhe qëndrimin tim me guxim të tepruar ndaj atij realiteti atëherë, mjerisht mjaft nga temat e atëhershme serioze kanë mbetur në një farë mënyre aktuale dhe të hapura edhe në ditët e sotme, gjë që mund të nxisë kërshërinë e lexuesve.

Sidoqoftë, kam mendimin se edhe këto "cacërime" (në ide dhe në vargëzim) ia vlen të vlerësohen dhe t'i prezentohen opinionit lexues të kohës sonë.

Prishtinë, korrik 1996

Autor

KANGË KAPUÇASH

I. Loja e parë

Kur e nisëm lojën me lue
mirë u dit kush ka me knue;
ka me knue kush asht ma i zoti
për qyqana i zi shkoftë moti!

Uh tajna, tajna tajna
uh tajna, tajna tajna!

Kokrra fshihet zor me gjetë
s`ndihmon fall as hyqymet?!
Nuk shkon jeta, jo, me inat!...
Janë do punë shkojnë me zanat!

Uh tajna, tajna...

O ti djalë me ftyrë t`vrame
humbësi gjithmonë duron t`shame!
Kush humb lojën e ungj kryet
merr legenin n`dash me u mbytë!

Uh tajna, tajna...

Mblidhni mend për tjetrën herë
se s`ju falim, mirë pa ju therrë!
Herë ju falim, herë s`ju falim
Ja lojë t`mirë, ja marrshi malin!

Uh tajna tajna...

Dhe njiherë po i ktheh`mi lojës
kujdes mendjes, kapak gojës
se po u ba e u humb dhe tjetra
s`ju lajnë proje, s`ju lajnë detna!

Uh tajna, tajna...

II. Loja e dytë

Loja e parë si krymb karremi
Ju mashtroi si bar veremi
Loja e dytë asht fort mjeshtrore
që t`vret cak- bam e nuk prish ndore!

rrunga xhung, xhunga rrung
rrunga xhung, xhunga rrung

Kush ke ai që u ba lavdosh,
Bira e minit treqind grosh,
Treqind grosh dhe me hi s`t`ze
pse lavdohesh kur syni t`rre`

rrunga, xhunga...

Kqyrnie mirë se kush asht humbësi
s`e lan gjoli, s`e lan pusi,
i muer n`qafë dhe shokët e vet
pa mend s`fshihet kokrra e shkretë!

xhunga, rringa...

Mblidhni mendt se kush s`njeh punë
ia sheh sherrin nji katund;
Molla e kalbët e kalbë krejt koshin
mbanie lidhë sikur Laroshin!

Rringa xhinga ...

Dhe njëherë n`u rrasshi n`lojë
do t`jua bajmë ma karabojë;
mendt e kresë këqyr mos t`ju dalin
hapni sytë se ma s`ju falim!

Xhunga rrumb...

III. Loja e tretë

Çohi djem me gëzim të këndojna
se fatbardhit i ndihmon ora
i punon syni, dora, mendja
fatlum jashtë, fatlum përbrenda!

Uh tajna, xung e bung
uh tajna, bung e xhung!

Hera e parë e provon synin
hera e dytë e provon trimin
hera e tretë asht e vërtetë
që të jep emën e të jep jetë!

Uh tajna ...

A janë këta trima a gra llahusa
qi s`po dinë me luejtë kapuçà?!
Ti mor djalë mos ban me gisht
dardha e ka mbrapa një bisht!

Uh xhunga ...
Kemi të drejtë jo veç me sha,
por me ju pre e me ju vra
mos me ju lanë gjallë për ditë të sodit,
veç na zhdryptë një mëshirë prej Zotit

Uh tajna ...

Ju mashtruem se nuk ju falim
qilnie derën marrshin malin,
po thotë mali nuk i due
jepja dreqit, qitni në përrue!

Uh xhunga ...

Jo ma shumë nuk po i poshtnojmë
Janë pak shtalba, le të mësojnë
Thonë gjynah me e ngucë sakatin
jepi shkas me mësue zanatin!

Uh tajna...

Reçan, shtator 1948

KAH KËNDOJNË ÇIKAT?!...

Oia, oia, oia, oia - a!

Me gisht në fyt çikat kur k`ndojnë
lisat pyllit ndalen n`gojnë
lugjet, malet n` vesh përgjojnë...

Çka thonë çikat me gisht në fyt
N`gemb bylbyli po i fshin sytë
lumi fushën s`po e përmbyt!

Me gisht në fyt kur po k'ndojnë çikat,
ndër pyllnaja lëshohen pritrat
darsmat nisen, ndizen dritat!...

Me gisht në fyt çikat po thonë
shpejt do të thuret lulëkunorë,
vallja hapet dorë më dorë!...

Dil ndëgjo si këndon çiknia:
"Ia, ia! ... shkoi robnia
pa kuleç pa gurabia!

Dil ndigjo çka thonë çiknia:
"Ia ia! ... vjen liria
me kuleç me gurabia"!

Ushton zani shpat më shpat,
mos u ço mor djalë lugat
lidh për toke tëndin fat!

Oi-a, oia- oia, oia - a!

(Reçan, shtator 1948)

KOHA ASHT AR

Mos të kaloj koha
shok i dashtun kot,
ajo s`blehet me të holla,
ajo s`ndalet dot...

koha plot ar asht,
vleftë të madhe ka,
prandaj mos thuej, ndasht,
po rri, sot, s`ka gja.

Asaj t`i rrish gati
se prej saj fiton
aty të lind fati,
aty t`fluturon!

Na duhet pikësëpari
panda të punojmë,
se ashtu kthehemi së mbari
jetën përballojmë.

(Suharekë, shtator 1948)

BESIMET E KOTA

Sikur gardhi pa huj thurë
që nuk asht pritë e kurrkuj
por sadopak na qet pengesë
n`ecje t'libër në çdo punesë,

ashtu kanë mbetë te ne ende
do therra të këqija nëpër mendje;
kanë mbetë hala do besime të kota
që për to, haptas, po tallen bota.

Për këtë shkak duhet pasë kujdesin
me matë hapin kah ta qesim
se besëtyta si ndryshk jetet
fort ngadalë zhduket e tretet...

(Gjakovë, 12.XII.1948)

MALLI NDAJ VENDLINDJES

Muzgu t`josh n`hijeshi të vet
dhe bylbyli kah këndon,
njeriu gëzohet me shëndet
lumtuninë në sy tregon...

Sa më tërheq kopshti në verë
me barë të njomë e me hije
si dhe lulet plot me erë,
uji i ftohtë e pemët me shije.

Hieshi ka, si ma kap bindja,
gjithkah sheh ky syni im
por atë vend që zë vendlindja
s`e plotëson asnji kujtim.

Përfytyroj tash në hollësi
vllaznit, motrat, babë e nanë
vallë, si janë, një zot e di,
punët, llafet qysh i kanë?!

Krejt rrethinën kam në kujtim
nuk mund të ndaj ma shumë ke due!
Jam i mbushun me përmallim,
vendlindje, e shtrenjtë je shumë për mue!

(Gjakovë, 15 maj 1949)

OJ KOSOVË

Oj Kosovë me male të nalta,
oj Kosovë me fusha t`rrafta,
lumej plot me ujna të bardha
me peshq plot edhe me ngjala;

plot me fllade vend-verim
plot me banja, ujë-shërim
me miniera, gurë mermeri
grunë e misër, topsheqeri!

me vocrrakë shumë faqetula
me gra të mira e me burra
që lumnojnë me të bardhat shpresa
që ma e mirë do të jetë e nesërja!

të jetë ma e mirë mveshun me gëzime
që mos të mbesësh kurrë jetime,
do të keshë nanën me u kujdesë
do të keshë miq e ndoj mikeshë...

Sot jeh zani në çdo shpat mali,
në çdo odë thuret mekami
për kangë të reja, kangë të lirisë
të besëlidhjes, të burrnisë...

Oj Kosovë, lule-shkëlqim
gjithmonë shkollën paç ushqim
përparimin paç stoli
t`u shkroft e mbara në histori!

(Gjakovë, nëntor 1949)

MARTIRIT TË HUMBUN

(elegji)

Kufomën e të mjerit
s`e pa frymë e njeri`t
veç synit t`skifterit,

i cili gjue ia ka
me sqep e kthetra tue ça
atë kufomë me gjakë la...

Nana e shkretë
shkretë që ka mbetë
ende pret djalin e vet...
ajo hala po shpreson,
djalin e vet andërron
kujton se diku po i jeton!

Edhe motra pret, oha,
ende shpresën mba
se i jeton ai vëlla...

Kot po pritni, oj dashni!
se ai s`kthehet përsëri
se e ka zhbi ai terri i zi!

Tash sa netë e tash sa ditë
shpendët e egjër tue qukitë
i kanë ngranë zemrën, mushnitë!

Mjer, e keqja, vjen ma e randë
bishat ma vonë e kanë ngranë
kurrëkund shenj nuk i kanë lanë!?!...

Kush asht shkaku i kësaj varre?
-Fare e fshehun nji batare
nji batare shumë kobemadhe...
Shëndosh nga burgu e kanë nxjerrë
e çuen lidhë kah Prroni i Fellë,
pas batares, mjer, e kanë therë!

Kështu me moh, nanë, kobi na vrau
me moh, motër, na shkoi vëllau,
kështu dashni, vepron fiskrra-u!?!...

(Gjakovë, nandor 1949)

**ÇASTE ZHGËNJIMI
PËR NANËN TONË**

Me lajka, me dokrra,
t`qiten pluhur sysh
kulshedra me gjithë këlysh

me gjithë këlysh kulshedra
kulaç të zi të përsheshi
teshë të huej të mveshi...

teshë të huaj të mveshi,
e ti për mos me dalë fare
pranove, s`pate qare!

Pranove s`pate qare
çka t`u vesh me dhunë
shumë randë, dreq o punë!

dreq u punë, shumë randë,
rri pa shndet, pa nder
barkun mbushë plot vner...

Barkun mbushë plot vner
he, fjala iu preft n`grykë
he dora i mbetë si pykë

dora i mbetë si pykë
kulshedrës që do me e ça
ma të shëndoshin tra...

ma të shëndoshin tra
ma të shëndoshin trung
që ndër shekuj nuk u tund...

Nuk u tund as nuk u mund
kurse sot me lajka e rrena
kanë fillue me gërrye përbrenda.
Nga përbrenda po e gërryejnë,
porse horrat, njerëzit e gjorë
do të mashtrohen, copë n`dorë;

asht copë në dorë, ta dijnë të gjithë
se kur vera vjen kah dera
ne do të shpëtojmë si përhera
se përhera na lidhë bashka

se i kemi rrënjët e lashta
s`mund t`na këpusi dhuna as lajka!

(Gjakovë mars 1950)

LULESHPRESE

Luleshpresë
që nuk thahesh
që nuk shuhesh
dhe nuk mpakesh

tash përulje
pse po i ban
shtrigës plakë
gurë e ranë?

pse s`i shtrinë
rranjët dhe ma thellë,
me gjetë ujin
trupin me këndellë?

pse merr kangë
pré t` mallëngjimit
para muzgut
e n`ferk të agimit?

Njome biskun
përtej ranës
mos e harro
mësimin e nanës:

mprehe fatin
me çka ke
e mos i druej
askujt mbi dhe...

se ke diellin
që të ngrohë
se ke ujin
që të ftohë!

kur ke tokën
për yshyr
kur ke gjethet
kullesë t` mirë!

Fresko ballin
merr frymë lirisht
hape rrugën
për lulishtë!

ndërroje ngjyrën
mos rri varë
ngjishe gunën
dritë të bardhë!

Luleshpresë
moj luledritë
mëshirë nga qielli
s`ban me pritë;

S`ta shtrin dorën
askush ty
me t`pa n`flakë
a n`rrezik t`zi,

prandaj vetë
forcoje rranjën
me ferk t`dritës
ngjyro kangën!?

(Reçan, gusht 1950)

PEMËMADHES SONË

1.

Po më bjen hise me të këndue
edhe pse n`ty s`jam qillue
moj pemëmadhja e lashtësisë
libërtrashja e historisë...

Shumë çudi, çka banë me ty
si t`kanë prishë e të kan përly`,
nuk dukesh ma ajo pemba e parë
të kanë sulmue me kmesë, me sharrë
do degë t`shëndosha t`i kanë pre
s`ta kanë lanë pamjen si dje...

Gjithkah lulet po lulojnë
veç te ti shumë po lëngojnë!?
Dikush në ty asht inatos
po mundohet me të shfarosë
me të shfarosë mos me të lanë fije
me ta humbë çdo pikë gjallnije,

S`po di kujt i bane faj
që n`vend të ilaçit, të jep rrazgaj?

2.

Dikur ishe si nanë me fëmijë
që shumëkushi të kish lakmi
t`kanë lavdue kishin për se
shej t` mirë kishe ti n` këtë dhe:

me trung të fortë, madhështor
degësh thurë kunorë-kunorë;
gjethe, fryte, plot prarue
syni kënaqej tue të shikue;

dikur rr`fesë ia ndalshe turrin
s`kish shtrëngatë me ta ndalë vrullin;
te ti n` dimën ish shtrojerë
freski joshëse kishe në verë;

kishe frytet plot mjaltim,
lypte i sëmuni për shërim...
Ke qenë vend me hjekë merzi
tash t`kanë ba siamazi!

3.

Ke qenë truell, arë bukanike
tash t`kanë ba si djerrinë fike;
t` rrëzuen shumë, tash s` ngreh n` kandar
as sa pluhni në një shoshë farë!

Po të përdorin me zanë shtek
s`po kanë dert, pse vuen, pse hjek,
t`i kanë vu kthetrat në fyt
dofarë grejzash me fytyrë të ndytë!
S`po lejojnë njerëz, shpend a bletë
kundruell teje me u endë, me ndejtë.
Sa herë sythet që po të shpërthejnë
krymbat çojnë që t`i mbërthejnë!

T`banë ... çka s`bani vaki kurrë,
krymbat n`ty me endë pëlhurë,
ti për grejza me u ba urë
shtriga t`lidhi kambeduer
dhe n`shpinë tande parazit
sa po mundet me të grabitë!...
Me degë tueja ngre shtëpi
me mund tandin shtron gosti!

4.

Dhe sot për ty shtegtarët fjalojnë
mirësinë tande s`e harrojnë.
Ke pasë sheshe pushim për mik
shnoshshe shpirtin si muzikë!

Tash veç emni gjallë të ka mbetë
por jo jo!... Nuk je për dekë.

Mos harro, se stina ndërron
shtatin rranja ta forcon
dielli prap do të ngrohë me rreze
do t`i forcojë frytet nënë gjethe!

Në vend të grejzave të asaj shtrige
do të vijnë bletët pa kurrfarë frige
tue thithë lule, me të përtëri,
me të dhanë forcë e gjak të ri,
me t`vesh prap degësh prarue
kunorën sërish me ta plotësue...

Shtriga e motit kur të shohë ty
t`vjellmet prap ka me i përbi
qysh e tek, s`po hy ma thellë,
janë do punë që fati i sjellë...

I sjell fati po ma shumë puna
i sjell dija e kundërdhuna.

Moj pemëmadhe, hiq plogshtinë
ripërtërije historinë...

S`do të jeshë jo, ma plaçkë e hedhun
s`do të jeshë ma, jo, ujë i derdhun
do të marrësh veten, siamamirë
dritën s`ta ndalë nana natyrë!
Dhe prej ballit hiq kllapinë
nxiti forcat që n`shpirt të rrinë;

Mos dysho, merr frymë ma lirshëm
fryti yt do të jetë më i shijshëm!
Pipa të rij, përreth po të rijne
me gaz zemrën ta përtërijnë!

(Gjakovë, 6 shtator 1950)

FORMIMI I KOOPERATIVES FSHATARE

(pasqyrim e propagandim kohe)

Iku dielli, perëndoi
toka, qielli errësoi
n`oxhak flaka blozën lëpin,
bora jashtë mbulon çatinë...

Babë e djalë n` odë bisedojnë
heshtin muret dhe ndëgjojnë:

-More babë, sot isha në qendër
për katund asht dhanë një emër:
konferenca shumë do të kemi
për një çashtje me randësi,
krej katundi kështu si jemi
n`kooperativë duhet me hy...

Sekretari që edhe ti e njef
tha, kjo punë t`mirret me qejf,
dhe më bindi që për këtë punë
duhet me pri ma së pari unë.

/Thekshëm baba i ka folë,
shej ndalimi i ban me dorë,
me djalë t`vet po i vjen çudi,
për atë gogëluq që e kish përbi!
E shikoj pak me bisht t`synit
dhe i mëshoi rreptë, si rr`besha dimnit: /

-Ma ngadalë, djalë, mos u ngut,
mendo pak, këqyr, preki trutë,
pa nevojë, mos hyn n`thellina,
me sy n`ballë, s`shkilet e mira!
Mos hyn, biro, thellë te lumi
se t`prapton, të shtje përfundi!
Mos shpejto, pa mend me vrap
se droj bjen me kry n`trap!
S`bahet hop pa u këcye gardhi
shumë punë t`ngutshme s`i kap qari!...

S`ndeجتa bashkë me vllain tim
por u ndamë me gjetë qetësim

e po të rrimë bashkë me katund,
kështu diçka mos çil kurrkund!

Çka po thue ashtë larg për mendje:
tjetërkush zotnues n`shpi teme!

/Ndëgjoi djali idhshëm boll,
luejti vendit, pak u koll,
vuni gishtin n`tamël t`kresë
i tha këto fjalë, hiq pa u mërdhezë:/

-Babë, m`beso, s`e kam qëllim,
me rrxue qerren për çdo kthim,
por po due t`kem ujë n`livadh,
t`keqes, tmires me i vu gardh!
Me hap t`kohës me ecë përpara
se ndryshe s`kapet e mbara.

Shiko dielli, lind perëndon,
pa nda stina, koha ndërron...
Ti ka kohë n`shoqni s`ke dalë
veç në do punë: në arë e n`mal!
Sot ka shkolla kate-kate,
politika zien shumëfarëshe.
Shumë probleme nuk po i sheh
pa i pa punët dhe nuk i njeh!
Janë do fjalë që e thonë të vërteten
e reja gjithë lufton me t`vjetrën...

Ai njeri që s`ec me kohën
e shkel veten, mund të humbë kokën...
Ndërrojnë adetet si ndërron moti
me forcë ndahet gjithë ma i zoti,
qofte më pushkë, me mund, me mend
qoftë me shkolla, me kuvend.

Gjithkund ndahet luftëtari
lum kush t`resë i prin ma së pari!...

/Me vëmendje i jati po e ndigjon
do fjalë të mira ia lakmon
e kish falë zoti mendje hollë
po s`kish ba kurse, s`kish ba shkollë:/

-Na, vërtetë, pa shkolla ishim
dhe shumë punë vërtet s`i dishim,
po mbi shpatulla t`randen barrë
kurr s`e vejshim sa ma parë!
Kush ma së pari t`"rejat" ngarkonte
veç kosisë kurrigja s`fitonte!
Pleqt kanë thanë mos pri si n`mjegull,
punët me kohë v`nojnë edhe rregull.

/Baba foli dhe diçka të dyshimtë
se t`kaluemën e kish të idhët,
ndërsa djali gjakftohtë vazhdon
ma mirë fillin e tfillon:/

-Do pleq moti s` shihnin dritën
shkollës, fëmijes ia ndalshim rriten
tue punue për t`huej e horra
fëmijët e vet i linin qorra!

Ne në luftë me partizanë
u munduem ndopak me nxanë
dhe me kurset që mbaruem
horizontin e zgjanuem:

"kolektivi" asht bashkimi,
asht për popull përmirësimi,
ku ka hajr s`duhet pasë frikë
mbyllun n`vete s`ban me u mykë!

E zezëditë kush s` e njuh fatin
vuen, stërvuen tue pasë zanatin...

A di mësim qysh pate dhanë
e tash anash pse me e lanë:
bashkimi, thoshe, ban fuqinë,
tash ndërmend këto s` po të binë!

"Kolektivi" njeriun e ndreq
ia heq krejt vesin e keq!
Kjo farë dere që po na çilet,
asht ilaç i madh, po dihet.
S` do t`mbetesh vetëm pa kërkend
por me shokë, me krahë, me vend!

Në "bashkësi" s`humbet kurrëgjja
do të keshë shpi, mall edhe gja,
punon fiton tash jo për zotninë
por për vete bashkë me kojshinë.
Me tepricë që nxjerr fitimi
do të bjejsh mjete agrumimi.
Me makina, me traktora
punohet mali, punohet toka!

Ta ban dora ç`ka t`thotë mendja:
pleqt, menttarët krijojnë ndër ndeja!

Kështu i vetëm s`ke mundësi
me marue as djep për fëmijë!

Nuk ke sot asnji turturë
andej zdapesh, flet pa u ngurë!

Të thërret e mira me hy mbrenda
mos me të lanë ashtu me brenga
e ti po tutesh mbyllesh në vete
thue se i dole n`krye kësaj jete!

/Pa mbarue, djali, mirë fjalë,
i thotë baba, ma ngadalë,
i foli rreptë pa e rrudhë fort ballin
dhe n`shikim drejt tash e mban djalin:/

-More, djalë, paske hy fellë,
keq po tutem, mirë, nuk të del,
kur t`fundosesh kush nuk të xjerrë
druej do të fyejnë, mendja ma merr!

Kah po prike ti, s`duhet nguti,
lypset do kohë, lypset urti,
s`duhet kapë kështu puna çark,
pa u ntrash sofra, s`fryhesh n`bark...

Për ata që shkoi e s`kthehet
e di mirë, s`e kam mbas krejet,
dhe për shkolla dijeni
qysh ka qenë mos m`shto merzi.

E di baba, historia
si asht ruejtun shqyptaria
me pak shkolla, pak mejtepe,
me pak pushkë, me pak dyfeqe
me pjellë të mbarë, me punë e vim
ruejtëm veten, s`bamë harrim.

Ruejtëm gjuhë, ruejtëm vend,
ruejtëm besë, nder, plang, kuvend...

N` male e fusha diqysh jemi rritë
ecëm, erdhën deri në këtë ditë,
kurse ti veç me do fjalë
do me dhanë krejt çka ke t`gjallë!

Në "kurse t`jueja" në atë "shkollë të re"
druej se yshtje po mësoni atje,
mos u bani kështu si do sehirbaza
që t`i merrin mendt me do pallavra!

T`qesin fall, rrena për së kthjellti
kishe dinë ma mirë se shenjti!

...Hajde, hajde, në atë kooperativë
që ty po t`u dokka aq e mirë,
nëse të ka ra n` short, pika e zarit,
mund t`hysh me shokë, por jo së parit!
Shyqyr toka sot u ba e jona,
pse me qartë pa qenë nevoja!?

Ndoshta sytë e mendja m`u kanë errë
por me pri vetë, mendja s` ma merr!...
S`ka shume vjet jemi çlirue
pse s` na lanë pak me pushue,
pamë shumë vuejtje hiqnim keq
ishim n`zor sa me luejtë menç
prej xhandarit, prej horr-horrit,
t`vrante qenin n` dyer të oborrit.
Qellim kishin, e dinë te tanë,
me na marrë tokën, me na përzanë.
Na luftuem për tokë e punë
kemi durue zjarm e dhunë
këtë vend për së gjalli nuk e lëshuem
po këtu vuejtëm si të ngujuem!

Fëmijëve u siguroem pak bukë e krypë
që mos t`kapin kryet me dalë me lypë...

E tash n`"liri" thue t`ia kthejmë shpinën
mallit, tokës, gjellë që s`hahet, pasha mixhën!
por ju me pak shkollë e do t`rinj mendjelehtë
po i ndërroni llafet, po gjykoni shpejt!

Shpejt mund t`ju mashtrojnë do fjalë të thata
e po i bleni kësollat si t`ishin pallata!

Sa për këto që thue, s`asht aq lehtë,
nuk është punë që bahet n`beft...
me vullnet, thue, pa qykë të zorit
s`ban me i pri, jo, sa anës vorrit!

/Thellë n` mendime ra tash djali,
shikoi babën dhe ofshani,
n` fytyrë e pa si t`shkrueme n`letër
mosbesim dhe kurrigja tjetër...
Kështu e mundon, po, mosbesimi
kështu e grryen brend krymb-dyshimi.
Plaku n`mjegull s`do me u rrasë
n`drrasë të kalbun dron të shklasë,
prandaj djali thellë mendon
këput bisedën për më vonë.

Doli jashtë ndoj punë me kqyrë
a po kryhen si duhet si n`detyrë
me i këqyrë gjanë, dru me coptue,
dhe pak kokëdhëmbjen me e largue!...

...Mbas sa ditësh sërish vazhdoi
dhe kështu fjalët mirë i rendoi:/

- Do të vazhdoj, babë, për atë punë,
që ti e more pak si me furtunë,
për kooperativën që asht në program
pa folë e pa e ba qare nuk kam...

T`falemnderit, babë, për vërejtje
ia njeh mirë ti huejin kësaj jete
po çkado që thotë e mëson partia
atë asht shpëtimi, burrnia e jo koria.

S`na mashtron ma kurrë pushteti
për me marrë toka për veti,
se tash vetë populli asht pushtet
do të jetojë ai si do vet.
Por partia me do plane e nisma
do ta drejtojë me mend, pa krisma
drejt lulëzimit, përparimit
drejt bashkimit e vëllaznimit!
avangadës, socializmit,
me i çelë dyert e komunizmit!...

Nuk do të ketë bela e t`mbyta
nuk do të ketë gyrbet e t`liga
do të jetojmë me forcat tona
kooperativën do ta gëzojna
se ajo do të jetë burim e masë
fryte e të mira ma shumë me pasë
që mjerimit t`i japim fund
si kudo dhe na n`katund...

Tash pushteti nuk tradhton
nuk plaçkit as nuk sundon
tokën ka ai që e punon,
kush punon dhe përparon!

Puna e jeta në bashkësi
na sjellë pasje e lumtuni!

Mosbesim, kodër mbas bregu,
mund të na qesë ndojfarë birë begu
ndoj kullak a ndonji reaksionar
që rri mësheft shtiret luftëtar...

por jo kurrë klasa punëtore
që në luftë korri fitore!
as ajo e pastra katundare
që ndihmoi luftën me haje e pare!

/Baba tash ma butë e merr
ndëgjon djalit kah po tjerr
po i tjerr hollë do llafe t`ditës
që po lëshojnë erna t`politikës!
Politikë kjo se jo për mahi
që u fut thellë në çdo shtëpi.

Tash pak me djalin po ndërron fjalë
jo aq thekshim si ma parë: /

-Fjalët janë të mira, qysh po shihen
kangët janë t`mira qysh po ndihen,
por çka po zihet në hyqymet brenda
asht shumë vështirë, kështu ma thotë mendja!

/Djali iu duk se n`kam e ndorë
e vrau shejn, s`e la me folë: /

-A di kush qeverisin sot
fjala tyne nuk lot dot,
janë djem të popullit që, për besë,
s` kanë për bazë tjetër interes
veç për këtë vend e kanë t`lidhun fatin
derdhën gjakun, dergjen shtatin!...

Nuk të lë n`lloç pushteti ynë,
po të jep dritë, të çon kah vynë
prandaj në ta mbështetu pa frigë
s`ka me të gjetë asnji e ligë...

"kolektivi" ku u mboll së pari
po ripërtrin botën për së mbari
ashtë bimë soje, me rranjë të forta
tash me ta po këndellet bota!

As lagshtia s`mund ta kalbë,
ashtë e fortë s`çahet me daltë;
kurrfarë zhegu nuk e thanë,
kurrfarë krymbi nuk e han
as shtrëngata s`i ban gja
aq shumë rranjë të forta ka!...
Dhe ka zemër t`fortë t`gjanë shumë
kunorë majesh, trup të lëmuem!...

Po na thretet me krahë të hapët
me hy në ta me kambë të djathtë!
Me kambë n` baltë ma mos me mbetë
po aty ku punët kryhen ma lehtë.
Asht ma lehtë se punët ndahen për shpi
sipas njeriut zotësisë së tij...

N`kooperativë forcat bashkohen
me punë t`mbarë të gjithë frymëzohen.
Shtëpinë tande kush s`ta prek,
dorë prej tokës s` ke me hjekë.
Punojnë të gjithë si n`t` madhen shpi,
dikush bujk, bari, mjeshtri...

Unë jam i nxehtë, thellësisht i bindun
se duhet të shkruhem, s`duhet pritun
se kjo asht e mira e të gjithëve
të jemi shembull dhe ndaj fqinjve.

Fundja t`kam pse të mos krenohem
dhe n`shoqni ku shkoj t` naltohem?
Mund të marrë dhe ndoshta dekoratë
për vepër t`mirë që e baj në fshat.

Për ne do të shkruiejë gazeta,
kudo do të hapet e vërteta
se jemi besnikë, në vijë të qeverisë
në rreshta të parë të historisë!

Jemi, pra, familje përparimtare
që i prin kooperativës fshatare!...

Babë po prijmë pra se me peshue
ngreh randë shumë, kem' me fitue!

/U mbështet plaku pak si menj`anë,
mbushi llullën me duhan,
vuni pipin në lule të ballit
pak shikimin hoq drejt djalit,
fërkoi rrudhat, lëmoi mustaqet
me shpinë të dorës preku faqet,
nuk po flet tash me të vështirë,
por ma prajshëm e ma mirë
tue ruejtë pak gjaftohtësinë
para djalit shpreh urtinë:/

-Unë fort mirë, birë, të ndëgjova
asnjë fjalë huq nuk ta çova
mendsh më ra një fjalë e vjetër
që ketë rast zë vend patjetër:
si asht moti ktheje gëzofin
se ta pret çdo gja hovin;

si bjen lodra duhet kërcye
petku i zhyem pak ban me u ngjye...

Shumë do sende sot i ha pazari,
por për do të tjera vret keq samari,
e premja keq dhe zhgunin e mirë
e ban ta pakandshëm e ban të pamirë!

Prap po tham ka punë me hile,
për mashtrim shpiken kajstile.
Nji mendje m`thotë po pleqnon mirë
mund t`shkosh ta plotësish tanden dëshirë
por ma i pari mos u shkruej
mos i qit t`tjerët si dhent në ujë.

Punët e fshatit kanë ngatërrime
gjithherë prijsi merr mallkime.
Shahet kur s`u bjen për shtati,
me u ra mirë, thonë, ndihmoi fati.
Me shkrue ndër të parët, jo, s`kemi shtek
e na raft keq po vuejmë si krejt!

Po më dhimbet mosha me turpnue
me u ba punët mirë pa i pleqnue...
Ma së pari po bajmë dert me shokë,
barabar shkon shpirt e tokë.
Për mos me hy sëkoti n` bela,
kënd pa e ngucë e kënd pa e vra
duhet këtë punë mirë me ndreqë
bashkë ta ndajmë qoftë mirë, qoftë keq!

Për me hy i nxet nuk jam
pikë dyshimi n` shpirt e kam
por janë do punë që s`don shumë mend
kush s`ecë përpara ngelet n`vend!
Bota asht për ju, për të rij
çka po doni mirë s`po di.
Veç lum baba, lojë mos bani,
se me mund e gjak ruhet vatani!
Për këtë popull mirë punoni
çka asht ma mirë për ta mendoni.
Çka `i herë fitohet me zor jepet
malli afër s`ka pse të shkepet.

Rueju hasmit, rueju trenisë
forcoje fort shtyllën e shpisë!
Jo pak herë: rrena, lajka e dokrra
me strajcë e thasë na shiti bota!

Liri të vërtetë fort pak gëzuem
gjithë na rrejten, na mashtruen;
tash si vonë po marrim frymë ma lirë
me luejtë me toka, hej, nuk asht mirë!

Me "kolektiva", me këto farë "zadruga"
keq po tutna po na humbë rruga!...
Kështu qysh duket, s`di sa kam të drejtë,
asht pyll pa rrugë, drojë me tretë?!

Drejt me thanë me pri s`kam guxim
fort po droj për të madh "sharrim"!
Ndoshta ju i kini terezitë me vend,
por s`due n`qafë me marrë kurrkend.
Pa mendue mirë, pa marrë hetime
s`mund ta bajë këtë zemër trime.
Dita e re mund të sjellë fat të ri
shkokloni këto punë hala n` parti...
Ka do kohë i kam ndie do fjalë
"kooparativa", thonë, krahë ka marrë...
Krah ka marrë, thonë, ec si sahat
por mue, thashë, le të më lanë rehat!

Po ti ma i pari më mbështete murit
fjalë ma shumë nuk i vyen burrit...

/Priti djali si i ka hie
mandej plakut i kallëzoj
se e kish detyrë partie
koopativën t'a formojë.
Një gëzim ia përshkonte zemrën
si rrezja që e zgjon pranverën,
akulli i parë për të u thye,
por shumë punë kish deri n`krye,
rrëshqethja trupin ia kaploi
punët me të tjerët kur i mendoi.
Nuk kish front kundër anmiqve
por si mendjen t'ua mbushë miqve...

T`ua mbushë mendjen katundarisë
me direktiva, me fjalë të partisë,
armë kjo e "bindjes efektive"
që përcillet në popull, nëpër "aktive"!

...Si shkoi djali në konferencë
at mbasdarke n'odë të plakut
erdhën fqinj të me qajtë dert,
hynë në odë fjalët e sokakut.

Biseduen çka s` biseduen
e çdo gja mirë e shokluen,
folën hapët, dolën pa frikë,
qitën në pah si t'mirë si t'ligë.

Ç'mund t'u sjellë kooperativa
që pushteti kish kërkue
bashkë me të këqija e të mira
lëmezët mullarit duhet vnue!...

Shkonte koha, fjala zihej
në atë buzëmali, përçka dihej,
Një natë n'odë të plakut hyni,
të pranishmëve fjalët u ndryni:
një i ardhun, mik qyteti -
ish vetë shoku prej komiteti!

Si zotshpije plaku ynë
priti mikun si do zakoni,
u soll mirë, ia la çel synë
e bisedë t` rrastë morën së voni...
Përveç tjerash musafiri,
kështu u tha të gjithëve troç: /

"Paj, ky vend, ky vend dëshiri,
n'shumë fortuna t'zitë e hoq.
Për me mujtë më kthye mbarë vendin
për me mujtë me u pasunue
për me i shëndoshë plagët e gyrbetit
në pushtet diçka t`mirë asht mendue:.
Asht gjetë fort e mirë një qare:
kooperativa katundare!
Këtë duhet formue në çdo fshat,
besoj se të gjithëve u shkon për shtat.

Anembanë sot vendit tonë
kooperativat veç po formohen
Dhe në shtyp tash po lexojmë
rezultatet kanë zanë po korren!

Kjo asht masë e re për katund
kur shfrytëzimi mori fund,
masë e re kjo socialiste
çelës për jetën komuniste,
kur të pasun të gjithë do të jenë
kur punë pa mund do të gjithë do të kenë
se çdo punë të randë do të kryejnë makinat
dhe do të plotësohen krejt dëshirat!

Arat do t`i punojë traktori
as një punë s`do të kryhet me zori
do të kemi makina, agroteknika
në çdo shpi - fshat do prajë e liga.
Në çdo fshat doktora- mjekë
s`do të ketë s`mundje, s`do të ketë hjekë
se populli ynë mjaft hoq krahthati
se djemtë e vet drejtues s`i pati.
Baza ekonomike ishte shumë e dobët
prandaj dhe njerëzia jetonte plogët!...

Populli punonte, mundin derdhte
vinte i hueji krejt ia merrte.
Tashti ndryshon, me luftë fituem,
s`duhet ndejtun të hutuem,
por gjithë t`mirat vetë t`i gëzojmë
kooperativën ta formojmë...

T`i formojmë ashtu si në Rusi
ku "kolhozet" po bajnë çudi!...

Dami rri karshi dobisë
mu si kuklla në dorë të fëmisë.
Fëmija rritet ia merr pahen
njeriu lodra shumë shpejt ndahen
Dhe kjo që po e formojmë risht
asht si mugullimi në qarrishtë...
Rritet mali, mbushet pylli,
shtohet krani, kënaqet syni...

t` shtojmë bylyqet me gja soje,
kjo punë shumëve u shkon për dore.
Punë që s` ndalen që i sjell stina
kështu asht puna dhe kah kooperativa.
Do të mbajmë kafshë e shpezë të racës
do t'ja rrahim mirë rrathët kacës,
do të kemi fitim të mbarë
s'kemi tash grykës zullumçarë
se atyne që ju mbush kupa me ujë
u derdhet shëndeti n'dhe të huej.
Na që jemi këtu do të jetojmë
jetë ma të mirë vetë do të krijojmë...
S`ka zotni, s`do të lamë kullak
as shfrytëzues, me të mjelë pa shkak!

Katundi juej, që njihet si fshat i parë
me pleq të mençëm, djem përparimtarë!...,
Sot a nesër pres me na kuptue:
kooperativën s`ban pa e formue!
Gërshajt vetë në dorë do t`i keni
matni e shmatni vetë do të preni.

Lumi ai që ngreh për së mbari,
ka meritë kush shkruhet i pari.
Kooperativa asht zgjidhje e vetme
për punët tona t`bereketshme....

/Pushoi pak përsëri vazhdoi
disa çështje i sqaroi,
katundarët i shtrojshin do çështje
me marrëveshje e pa marrëveshje
e therrnin me "kuja" me "vegsh" ngapak
"mysafiri" s`i hetonte: pak as tak!

Plaku ynë hetoi për së kthjellti
se disa ia mikun therrnin në konak,
prandaj vendosi vetpërveti
krah me i dhanë, me veshë ngapak!

Miku i shpisë pak njihte punë
ashtu si rrjedhin fjalët n`katund,
se i panjoftuni drejt me pre
për shtrembët hallkun kanë me ble,
prandaj plaku ndërroi kuvendin

ashtu hiç pa e çartun rendin,
ndërkohë erdhën dhe do të tjerë
që për këtë punë ma ishin thirrë,
dikush n'gaz, dikush ish zverdhë
puna dukej shumë e vështirë!...

Kur krejt u nisën me shkue n` log
ku priste katundi i mbledhun tok.
Lamtumirën plaku s` ua mori
por me ta, së bashku doli.
N`kapërcim ai tha një fjalë
-S'po të lë vetëm more djalë!

-e iu drejtue: - Kush mbeti brenda,
merrni rragje, rrokopendla.
Çuhi burra krejt po shkojmë
n'log t'kuvendit të vendosim,
atje asht vendi t'i sheshojmë
dhe si t'jetë ma mirë po e sosim!

Krejt mahallët e këtij katundi
do t`ia ngojmë fjalët e këtij burri!

/Dolen jashtë udhës rrugonin,
fort rrallë fjalë për rrugë pikonin.
Tash udhëtojshin për në kuvend
s` ishin të gjithë të mbushun shend.
...Plaku ecte lodhje s'ndjente
ish diçka që mbrend i ziente!
Vallë, ç`po ndodh me këtë kryefisi,
si fryn fryma a rrëzohet lisi!?

Kur mbërrinë te logu, në mes të fshatit
veç kish dalë hana prej shpatit.
S'vonoi u nxe konferenca
kish boll fjalë për PO e JO
disa ndëgjojshin si memeca
se mos po rrëshasin kishin dro'.

Pritshin se kah do t'ja mbajë plaku
që ish kryeparë i atij gjaku.
dhe e ndëronte krejt mahalla
për punë t`mira, jo për kopalla!

Nisen hallkun fjalë me hjedhë
se qafa e plakut s' hyn n'atë zgjedhë,
dhe se do t'i prapë ata axhami
që po duen n'kooperativë me hi!

Plaku tash shumë mirë e kuptoi
rreth e rrotull sytë i lëshoi
kërkoi fjalën dhe e mori...
Tash po flet me një katund
një ka një llafet i zgjodhi,
kështu ia nisi e i dha fund:
-"Burra t'ndershëm, shokë e vllazën,
sonte jemi mbledhë si n'darsëm,
por n'këtë darsëm s'ndihet kanga
dhe pse neve s'na ka dalë gjama!

Fjalët huç fort mos t'i marrim,
por me mend e fort t'i masim.
Shpija madhe lëshon si bleta,
ndahet nipi, ore, t'u ngjatjeta,
t'ndahet vëllau, të ndahet djali
sikush n'shpi t`vet del si fatbardhi,
kurse toka e dini po coptohet
e bylyku, e dini, po shëmtohet,
shpija e re po ka shumë zore,
boll gardhiqet nëpër oborre...

Me ka nji ka, magar a lopë,
nuk punohet, jo, kjo tokë.
Pa u plehnue toka nuk pjellë
toka shterp gyrbetin sjell
e gyrbeti asht një e zezëfaqe
ta fut kobin ndër konaqe
e kooperativa që sot po flasim
për të gjithë këto, thonë, ka ilaçin.
Do të punojnë, thonë, të gjithë me pagë
qoftë me shati, qoftë me shtagë,
qoftë me drapen, me gjylpanë
qoftë me fëmijë, kush bahet nanë!

"Po" e "jo" këtu po ndigjojmë
për me u shkrue fort po ngurojmë
asht gja risht s`e kemi provue,
pale fati çka ka me na prue,

si thonë këta t` shkollës, ma merr mendja,
se do të jetë diçka për dobi
nuk asht keq, pra, me i hy për brenda
n`punë të mbarë kush s`ka lakmi!...

Po thonë, asht e ditun, s`asht provë e re
dhepse fort risht po hyn ndër ne.
Pra le të vendoset n`këtë tubim
a ta bajmë si të tjerët këtë bashkim?!...

Ma të vyeshmit mund t`na udheheqin
tue mos lanë anash e pa punë askendin!
Njerëzit me shkollë që po i njoh unë
thonë do të ketë rregull "kanun".
Ligji i vendit vetë do të flasë
gjithkush t`drejten ka me pasë!
Qysh punon ka me korrë fitimin
me gëzue verën, me gëzue dimnin!

Pyes a i pshtetmi, pra, kooperativës
me ia dhanë kështu krahun të mirës!?

Mbi lumë duhet qitun urë
arat në mal duhet me i thurë
punët zhag s` duhet me i lanë,
por me i krye si kush me plan...

Sall nji njeri s` mund të mbajë shpi
ka dëshirë shumë, po s`ka mundësi
e katundisht punët me i pleqnue
gjithë kah e mira kanë me shkue
dhe kurrkush s`lodhet as për fare
bashkarishtja ka forcë të madhe...

Njerëz të pushtetit e mendje hollë,
njerëz të dishëm dhe me shkollë
me u lidhë bashkë ne po na thonë
ashtu, thonë, lypka e mira jonë!

Qysh po shihet t`rijt mëzi po presin
që kësaj pune lëmezët t`ia qesim.
Ata mos t`i pengojmë, t`u japim hak
se ata e kanë për shumë, na pleqt për pak!
Prandaj ata duhet edhe na t`i kuptojmë

pse n` kohna të reja ata do të jetojnë!

/Mbasi u folën këto fjalë me vend
mbretnoi heshtja në kuvend
fjalën e mori dhe përshëndeti
ai shoku i ri nga komiteti:

"O burra ndëgjoni Mixhen
se ai vërtet ua dashka t`mirën
s`asht punë shërri i njanit a tjetrit
s`është sherr i t`rijve e te të vjetrit!
S` duhet pa puna veç sot për sot
por për t`ardhmen për shumë mot.
N`rregullore, në kode e ligje
do të ndeshni në shumë zgjidhje
që ju n`miratim vetë do t`i merrni
kuadrot, drejtuesit vetë i zgjedhni.

Kur të zgjidhen drejt njerëzit e juej
s`mund t`ju tradhtojë asnjë i huej.
S`lë pushteti kund pa marrëveshje,
me mirëkuptim zgjidhet çdo çeshtje.
Ne do të ruejmë burrnin e besë
pa to asht shëmtin, asht faqja e zezë...

Ndoshta m`mbetet kafja pa u shkepë,
veç për fëmijë që rrinë në djep
se për burra që kuptojnë
mësit ma të mirë nuk e qëllojnë!
/Kur kreu fjalën delegati
foli, djali po s`e zgjati:
-Asht mirë të deklarohet gjithkush,
kush asht PËR, dhe KUNDËR kush?!

I pari "PËR" deklaroi kryesuesi
i dyti, s`priti, foli dhe mësuesi
dhe tek tuk ndonji anëtarë partie
që ishin të organizuem drejt asaj vije!

S`vonoi shumë plaku u paraqit:

-Fol dhe ti djalë mos na korit
Nuk e di mendjen e gjithkuj,
pale tek tjerët sa pi ujë,

po sikur djali mendon baba
shkruej shpinë teme, të jetë ndër t`para!

Si e kreu plaku këtë paraqitje
disa të rij bënë duertrokitje!

Disa fjalë e çan errësinën:
-E formuem kooperativën...

Kryesuesi tue mbyllë tubimin
-Pra për fund jap konstatimin:

Në këtë bashkim tash që po hyjmë
s`kamjen, t`keqen do ta shlyjmë
çka tha plaku i lumtë goja!...
/duertrokitjet muer jehona/

-Mixha Rremë të paçim për jetë
të rijtë t`i përqafojnë idetë!

/U përsërit shumë herë njizani:

-Mixha Rremë, qofsh, rrnofsh sa mali!

P. S.
Kështu u formue kooperativa
s`asht prallë, mor të gjetë e mira,
por asht një vepër vullnetare
me pasunue fshatin, jo me qitë fare!

(Gjakovë, 27. XII. 1950)

ZHGËNJIMI I BUJKUT ISH-PARTIZAN

I.

Thonë kur s` fola, kurrë s`gabova,
por pa folë s`mund u durova
ish vështirë me të humbë malli
si me të lëshue shpirti për së gjalli,
me të merrë dreqi me farë e fe
e mos me të lanë kurrë mbi dhe!...

Kur të humb malli, thonë, t` humb shpirti,
kur të lë fuqia, këputet ymyti
edhe gjamën jashtë mos me qitë
s`kish për njeri`n ma të zezëditë...

S`kish qenë mirë qysh në kohë të para
me nisë lodrën me kofshlarga.
Kush le thitë lavrat me i shkelë
ka me hjekë, n`sprovë ka me ngelë.

S` duhej lanë me i shkelë ata derëzi
që s`paten kurrë plang e shtëpi
po n`shpinë të huej me hypë janë mësue
me na grabitë, me na pusue!...
Po mbahen, po fryhen me mallin tonë
e na thonë, të paftyrët, jeni zgjue vonë!...
Tharma juej, thonë, s` asht për brumë
dhe pse jemi terë për pa u ngi gjumë!...

Me zor na shtyjnë të punojmë për ta
dhe s`e ndalin grushtin tue na ra
Bane fole ta bajnë: shuej! shuej!
t` shajnë, t` përbuzin si plaçkë të huej!

Na në vend tonë, por barkun thatë
për me djegë s`na lanë rrafatë
ka zaptue bisha bjeshkë me zabele
dhe na la qyqe, pa tlynë n` fërtere!
Po vërtet, dhe ne vetë kemi shumë faje
vetë e ndihmuem këtë fare "azhdaje".
Dikush me dije, dikush pa dije
dikush për një planc të coftë dhije!
Edhe sot ka tanët që po u bahet bisht

madje me ta lidhen si unazë n`gisht
tue lidhë kunorë, tue ba ortaki
veç me i shtypë vllaznit, me kojshi...

Eh, qysh po të vrajka buka jote
kur i zë besë gjithfarë koke.
Na dikush dhamë bukë e pushkë
me ndihmue "kangje" e "njushkë"
tash vaj halli, vajtim me vend
çka i bamë vetes, pse s`patëm mend!

II.

Na u ka nda sot zemra dyshe
tash dhe këshillat jepen ndryshe
nuk flet zemra, sot flet frika
janë mbushë njerëzit politika
me "vullnet t` fortë" shkojnë angari
punojnë për shtet s` mendojnë për shpi.
Unë n` vetvete mbaj ndry idhnimin
mos t` ma shohë kush n`fytyrë trishtimin.
Nuk vraj vetullat, kur shtrëngoju dhambët
i mësseh grushtet, kur i ngulë kambët,
se qenka vështirë me kenë rroghtar
tue i pasë tuejat livadh e arë
dhe kur i shtin mbrenda masullë e zahire
vijne t`i marrin pa kurrfarë mëshire!!

Hej moj botë, botë e zezë pise
me gjithë këto t`mira mbetëm pa hise...
dhe me folë keq kurrkush s`guxon
se bane fole asht drojë mbaron!
Se ka dalfarça, shumë si "stenica"
shkojnë kallëzojnë fill te "stanica"
e pastaj çka t`gjanë: s` t`lanë Drini
s`t`përlan zjarmi, s`të përlyen hini!...

Kujdes, të huejt fjalët nuk t`i ndalin
kur prej tridhetëve shpërthejnë, dalin!...
Me gojë tande mos folë pa dorëza
as në odë tande as ku pihet boza!
Se zezona fort keq në lak na zuni,
vaj, sa poshtë sot ra katundi!:

Kur ta shkelin mallin si barin në udhë
qysh me mujtë me ndejë krahët tue i rrudhë?!
Qysh u bamë kështu si jashtabegu
të thatë, të shkelun porsi dru shtegu!...

Vërtet, nuk më duket mundim ma i randë
kur s`lanë me gëzue mundin e mallin tand!

E ti duhet t`shtiresh i shurdhët, i shtangët
pa u përpushë fare, me kujtesë të mangët.
Edhe nëse të rjepin, thonë, ti za mos lësho,
në ta livorisin lëkurën ti mos u anko?!...
Edhe n`se t`i heqin copat sikur llubinës
dhe n`se t`i nxjerrin tri dredha shpinës

ti duro, mos pallë si gja e gjallë
ndryeje klithmën, pa e lëshue asnjë fjalë,
sepse gjuha, për qyqana, po bahka si shkak
me lyp atë që duhet: për me derdhë gjak!...

Pra ti ma mirë ecju, shko me vullnet në punë,
se kështu mësohesh bahesh njajtë për dhunë
e kur të pysin a je fort e fort i kënaqun
ti përgjigju tue qeshë, gëzim tue shfaqun:
"kënaqë e përkënaqë e i kallun flakë
mbasi m`ka ardhë tehu veç deri ne jakë,
kurse mue syni as vër s`më ban
se jam trim i fortë e jam azgan?!!

S`di deri kur duhet të durojmë me taktikë
vallë, a na hiqet vetiu kjo e keqe e ligë?!

Dhe n`se ndëgjjon ndonjë fjalë prej hallkut
se duhet luejtë pak duert rreth çarkut
dhe që bajnë fjalë për farë kushtrimi
ti mos i dëgjo se ke shpirt robnimi?!
Se ata gjoja dashkan me të hjedhë
mos me durue robni, mos me ndejë nën zgjedhë!
Ata t`thonë se s`duhet me u pjekë si në hell
dhe tokë për të huejin ma mos me mjellë!
Mos me i ndëgjue ma kangët me qifteli
që flasin për luftën, për të zorshmen liri,
kështu për ne mjafton sot veç me i zgërdhi dhambët

kur ata djersiten me afsh kah i këndojnë kangët!...

Thonë një ditë e re, sigurisht, do të vijë
por kur, në cilën stinë, kjo rri n`fshehësi!?

(Reçan, korrik 1951)

ZOGUT TË HALLIT

Zog i malit, zog i hallit,
poshtë e naltë sillesh vërdallë
ndalu i herë pashë sytë e ballit
t`bajmë dy llafe, t`hjekim mallë:

E shoh dhe ty kanga t`ka lanë,
t`ka humbë caku, ec pa plan
të ka humbë ajo shpresamadhe
tash s`po i sheh as karcejt n`livadhe!

S`gjen pushim askund në tokë
as ndër lisa, ndër çufraraja
mirëkuptim nuk ndesh ndër shokë
nuk gjuen miza, nuk gjen skrraja!...

Zogu i malit, zogu i hallit
unë për ty gjeta strehim
jo n` barnishta, n`gurtë e strallit,
po n`hambar të shpirtit tim!

Me shpirtin tim për disa ditë
do t`ushqej mirë, pa i dhanë lak,
por ke urdhën me u ngjité
nalt kah qielli rreth e qark.

E di mirë se t`than veriu
e di mirë se të mëshon dhe era
ka vështirësi që i di vetiu
por mund të dalin dhe të tjera!...

Nga naltë do të shohësh shumë fole
që janë prishë e janë ba shkrumb
do të marrësh vesh për tonin dhe
a e ka mbulue pluhuni me fund!

Do të shohësh dhe gjana të tjera
që për jetë bahen ligjrim
pse s`çohen burrat si ngahera
me i hy punës, paçt, n` agim...

Nëse vren se shok`t t`qejnojnë
me shpotije t`endin në lojë

dhe i sheh shpresat kah t`perëndojnë
ikë kah unë, merr veç përvojë...

Dhe tek unë ashtu qëndron vanga
pa shoqni t`mbarë s`mund të baj lum,
prandaj si tek ti mue m`u prajt kanga
m`u pre fati, m`u ba shkrumb!

O zog i hallit, o shpirti im
që me ty tash po end pak fjalë
due të jem me ty n`muzg e në agim
të notojmë bashkë n`t`jetës valë!

Por ma mirë s`po hy n`thellina
se dhe kohën s`e kam gjetë
as për kangë, as për kraina
jo me qajtun ndonji dert...

Jo pse hiq nuk i bie n`fije
jo pse mendja m`asht zhdavaritë
po s`pa i ha tregu, s`po ka hije
lehtë s`po bahet terri dritë!

Tashmbastashi dije mirë
n`hamar tem do të gjesh pushim
tjetërkund mos lyp mëshirë,
bahu i zoti, mbahu trim!

se n` krejt natyrën gjan e gjatë
kah po ik drita para territ
kush nuk duel prej shpendsh me matë
që kufijt t`ia caktojë tjetrit!...

Kufi kund për zog nuk ka
s`asht dro se e shkelë vendin e huej
andaj ti mundesh më shumë me pa
çka unë, i mjeri, nuk po muej!...

E di mirë, të gjithë kanë fole
asnjëni nuk rri pa hiq
njani n` bimë e tjetri në dhe,
s`tham se s`ke dhe ti anmiq...

T`kërkon huti, t`ndjek skifteri,
porse ti përdor "taktikë"
çohu me ferk kur njeri dhe tjetri
janë në gjumë, kap cakun, ikë!

Ngjitu naltë shikona ne
vendnumrojmë, a kemi ngecje
trego të t`drejtën mos gënje
apo shihet kund ndo'j`farë ecje?!

Shkurt vështro: jug e perëndim
një merak hiqma se m`asht mtekë
se atje thonë asht fshati im
asht i zgjuem apo rri fjetë!

N` qoftë se asht në gjumë të randë
merr drejtimin shko tutje
falmjushëndet me zanin tand
çohi thuej se dielli ka le!

Ngrehuni në punë, thuej, se po myki
po e han ndryshku umin e ri,
cili i pari, kush i dyti
zini vend bashkë me shoqni!

(Gjakovë, 18 prill 1951)

BRISKU I RIZBULUEM

Isha ndejun n`odë dhe... shih
nji sizhurmë ndjeja përjashta,
ashtu n`mendje diç m` u shpif,
nji si tym m`u duk kah kashta!

Kur me të shpejtë n`oborr unë dola,
dhe u pa: trazimi ish pa vend,
me përhupë atë vrap që mora
bana se po kërkoj nji send!

Për shpi të vjetër befas u nisa
papandehun, pa ndonjë qëllim
por atë nyjën t`lidhun që e kisha
lehtë ma zgjidhi ky "rizbulim":

Në një skutë atje hetova
disa lecka me varrele
prej habie duert i çova
flokët m`u ngjethen maje kreje...

Pak durim vetes i dhashë
ato gjana kur i pashë...

Jo pse pashë farë shenjë mjerimi,
jo pse gjeta landë studimi
por në sy më ra ai "brisku im"
që tek unë kish zanë prenim...

Kujtova jetën shpejt fluturim
si qemë dikur e sot si rrimë
kujtova ngritje dhe rregalla
bashkë me të dhe armët e bardha...

E marr, shikoj, kam mall të rrallë
prandaj do t`ja them do fjalë
jo për zjarr e për krajata
por për kujtesën që pshtoi nga nata:
"Me ty kur prejsha thupra, shtaga
gjithçka që kisha për nevojë,
m`çelte dita më zinte nata
me gëzim n`zemër me kangë në gojë.

Shumë kohë kalove dorë pas dore
nga të vjetrit tek të rijtë
trashëgim të kishim prore
që tehi yt na i ban me dijtë...

Brisk, sa e pate tehun shndosh
që të ndiçonte si hanë së pari
s`duel i ri as s`duel mjekrrrosh
hovin, ecjen në kohë të na ndali!...

Sa e pate, brisko, të fortë mënojen
që ishte shtrat, pushimi yt
gjithë anmiku kyçte gojën
s`guxonte kurrë ta ngrinte kryet...

Sa e pate brisko majën
që me teh gati t`u paska shkri
gjith anmiku m`puthi kambën
s`kishte zemër t`më rrijë karshi!...

Ishe i lidhur me tojë të fortë lini
që nga kalbja e moti t`paska ra
paskan dalë jashtë përdorimi
dhe do sende që jam tue i pa...

por jo krejt, jo, ore tungjatjeta,
s`mund t`i shpallim të pavlera...
me mësim të hueja të hodha, të treta
gjoja t`zavendësojmë me mjete të reja!

N`rrrena të tilla s` di pse ramë
e i hueji ruejti t`veten pallë
na vetë u premë e vetë u shamë
bile s`di qysh po mbesim gjallë!...

Pa ty t`këqia pësuem ma shumë
tash besoj se do të përtrihesh
s`do të lejojmë ma: punë për lumë
po n`breznina do të lihesh!

S`ka me ndodhë, jo kurr e para,
s`do të harrojmë, s`të lamë pas dore
s`ka me të pre ma e kohës sharra
se do të këqyrim orëpasore.

Do të çojmë fill te mjeshtri i ri
do të japim jetë e pamje të re
me të përkohshmen me të përzi
se shumë ndërrime u ban te ne...

Ndodh me të quejtë me emën të ri,
s`do t`i keshë, mbase, t`verdhat sumblla,
por nuk do të lamë, jo, pa stoli
si i lyp koha, si e do puna!

Thonë, t`vjetrës ma i doli boja
farë e re në tokën tonë po bin,
porse ty mos të hyjë droja
se prap vendi të ripërtërin!

Randësinë fort s`ta kemi dijtë
faj ka i hueji dhe jona papjekuni
janë shumë punë s`i njohin t`rijtë
s`kanë përvojë, s`njohin dredhi!

Ka prej t`rijve që bajnë punë për lumë
ndreqin prishin, s`bajnë mend shumë.
Copë n`dorë dije, o shtrejti im
se s`do të mbetesh ma kurr n`harrim!

(Gjakovë, 5 prill 1951)

NJË PËRRALLËZ FJALËMBASDARKE

Ishte seç na ishte,
një kohë jo të largët,
dhelpna, ujku dhe nji edh
banë lidhje të përbashkët!...

Dhelpna takoi edhin
që ish nda nga tufa
kah lypte luledredhëza
në ferra e gëmusha!...

-Ç`ban mor bukurosh
që rrasesh në therra
eja ti me mue
të gjejë do lule-shqerra!

Tufën nëpër mal
ti fare mos e ndiq
unë t`i siguroj të gjitha
ti mos u gajlo hiq!

se ajo tufa nëpër mal,
me plaka e me pleq,
ty rriten po ta ndal
po të bën te heqësh keq!...

Eja tash tok me mue
ty po të zë nun të ri
kafaz shtratin ta kam shtruar
apostafat vetëm për ty!

Do të jap tamël me mazë
ashtu siç lakmon ti
s`lag pikë shiu as fërflazë
s`do të keshë ahur po shtëpi!

Të premtoj me besë e rrëfe
s`do të mungojë asgja në botë
çka ta do zemra në këtë dhe
që ka dalë e shpiket sot!...

Pa vra mendjen mendjelehti
u besoj llafeve të thata,

e kuptoj shpejt çfarë e gjeti
dy sekonda iu banë të gjata...

por tash ish vonë, pa një pa dy
dhëlpna brendë shpejt e ka ndry.
Dhe filloi të bënte plane
si ta hajë ashtu dalëngadale,

por kumbar - ujku n` bef i erdhi
dhe sa mor vesh ku ish mbyllë edhe
jargët i shkuan, ndikullës i tha
-Ma jep edhe tash ta ha!

Zonja i tha, - peqe zotni,
unë këtë edhe kam zanë për ty,
veç tash nuk asht drekë as darkë
e keci e paska barkun thatë!

Ta lejomë t`hajë gjethe t`njoma
s`ka ku shkon tash nafakjona
s`njeh farë rruge, s`i lashë ferkem
le të rri këtu në oborrin tem!

Dhe na të këqyrin kah ajo gropë
mos po e gjejmë ndonjë mështjerrë a lopë
t`sigurojmë kështu mish ma shumë
para se të bijmë rehat në gjumë!

Vërtet edhe ia hoq ngujoren
tue ledhatue me fjalë gojëvoglën
-Zgjidh do gjethe mor sy ambël
dersa t`shkoj ta sjellë do tamël...
që e kam lanë te gurra n` fllad
ti rri kësajd mos ik ma larg
se po bane me e thye besën
kurrë prej dere s`ta hjekë rezën!

Nana e mësimit asht përvoja
edhin tash po e mëson nevoja
-Po moj teze kësajd do të rri
se po më pëlqyeka shumë kjo shpi!...

Ata të dy si u larguan pak
ky vështroi rreth e përçark

dhe me të shpejt mori arratinë
me lypë grigjen dhe barinë...

Kur ujku e dhelpna këqyren me zanë
tash n` tufë keci ia kish dhanë.
Mblodhi mend që kurrë mbas tashit
mos t`i ndahet tufës, as babë-capit.

Sa mirë zënkat keci i shfrytëzoi
rrencat rrejti, veten shpëtoi...

(Reçan, gusht 1951)

PRIJSI I RI I TUFËS SË VJETËR

Në këtë pllajë të gjatë e të gjanë
e rrahun me rreze e me erna të lehta
plot kullosa an`embanë
rreth zabelesh ka tbane t`vjetra...

Përgjatë luginës anës prronit
ku shtrihen lendinat plot me barë
gurrat e ndrequna prej motit
na e kujtojnë fisin e mbarë.

Maje kodre përtej atij shpati
nëpër kasolla rreth me shkoza
jetojnë dhe sot do fise të vjetra
që shkojnë larg, s`u dihet mosha.

Për banim këtë vend kush s`e ka
për kullosa asht vend me famë
por vendasit gjith rrinë tue qa
për skamje, krizë, mjerim e gjamë!

Dhepse s` voni patën t`korra
prap gjamën s` e kanë ndalë
si me i kapun ngrica e bora
e jo tash vera që u ka ardhë!?
A mos qajnë për mend në kokë
a për të tjerë që heqin zi
apo zihen shok me shokë
po ju tregoj këtë histori:

Jetonte këtu një tufë me dele
grigjë që shtrihej në tanë këtë vend
jetonin me dashni e me përkëdhele
s`kishin ankim për asnji send!

Fati i zi çon një furtunë
e në furtunë u mbyt ogiqi
prej atëheri gjamen vunë
dhe nuk zgjodhën kurrfarë prijsi!

I fajshuen do desh të rij
që qitnin shkelma si atllarë
kurrqysh s`mund të binin në ujdi

për me e zgjedhë një kryeparë.

Për me pasë razi në shpi
çdo të përleme për me ndalë
u pajtuen që përkohësisht
një magar ta bajnë të parë!

Po magari dhepse magari
ai për veti keq s`punoi
së pari hoq tej frej e samar
s`dyti fronin rregulloi.

N` teferiq ftoi dhelpnën zojë
dhe pasi krejt fshehtësinë ia tha
kërkoj mësim si të sundojë
dhe ta çojë jetën me sevda!

Dhelpna dhelpën ... me i ra shkurt,
-Me të shpejtë, tha, mbli dhe mexhlisin
bjeri ambël urt e butë:
thuej ju vetë ta zgjedhni prijsin.

Veç dy kushte duhen plotësue
para se prijsi të ulet në fron
një, krejt shokët duhet me i rrëzue
dhe dy, atë lis që po e shikon!

N` log t` mejdanit do të ndahen trimat
të bahen ushtrime, para se garat të mbahen
më vjam t`kingjit lyhen brinat
rrunza t`pjekme ma vonë hahen!

E për ty kumbara mbret
lyp tershanë me thera t` njoma
dhe t`i hiq mos ke dert
se mbretnia do të jetë jona!

Derisa desht mirë t` ushtrohen
nëpër lisa e me shoqishojnë
ata ma shumë do të hasmohen
na prej froni veç i shikojmë...

Vërtet banë qysh mendoj dhelpna
për një kohë krenat sakatuen
por do dhen, jo nanë njerka

këtë marri shpejt e hetuen!

U thanë deshve eni në vete
as s`po shihni a s`po dini
mos ngatërrohi ma ndër vete
po të gjithë s`bashku fronit bini.

Mos ngatërrohi kotsëkoti
se i hueji na i molli të këqijat
a s`po shihni se jo veç syforti
por edhe dhelpna po i vjel të mirat...

Ç`asht ma së keqi kemi venë re
se ajo dhelpna po vishet tepdil
po vjen natën dhe ndër ne
po na mjel ashtu pa mëshirë...

Por edhe dhelpna në anën tjetër
Kumares ia vidhte dhenë nën kambë
deshve u shtirej mike e vjetër
-Mbretit- u tha - hiqnja disa dhambë...

Se shumë po ha dhe shumë po pi
dhe po sillet si asllan
vendin krejt ju kthei në robni
u ba i sert, u ba tiran!...

Fjalës së saj kur u ban amin
disa desh, disa vërgana
dhelpna qeshi buzët lëpin
-Sa lehtë rrehen - tha - këta hajvana!

Por, s` shkoi larg, një pika e djalit
me shokë të vet ish besatue
mos të rrëzojnë ma lisat e malit
as ndër vete mos me luftue,

Po me forcë e me dredhi
të largojnë dhelpën e gomar,
ta zgjedhin vetë një qeveri
të venë në fron ogiq me radhë.
Ashtu banë sikur menduen:
Rrëzuen magarin, zonjën dhelpën
çka ish shtrembnue e drejtuen

morën rrugën, atë të t`vërtetën.

Sot në këtë tufë të dhenve t`bardha
dhepse hala ndihet ngapak gjamë
Punët tregojnë se asht nisë e mbara
s`ka mbshtjellim e hallakamë!

Për pa zor e keqja s`hiqet
pa mund tandin s`ke shpëtim
magari, dhelpna duhet të ndiqen
sa ma parë t`mbesin kujtim!...

(Gjakovë, 4. III. 1951)

ZANI I TRIMNISË

(kushtrim)

Zani i trimnisë
endet tash sa vjet
kërkon veshë që ndinë,
kërkon gojë që flet;

kërkon zemër trime
në këtë nënqiellin tonë
të kujtojë të kaluemen
si kemi pasë zakon;

si kemi pasë zakon
si kem pasë traditë
me trima e trimnesha
vendi s`asht koritë...

Të kujtohet Tringa
të kujtohet Shota
Azemi me trima
që i njohi bota

Të kujtohet historia
Gryka e Carralevës
Hasani i Reçanit
statujë midis degësh!

Mes dy lisave mbështet
qëndroi në istikam
i doli shpirti n`kambë
priten ku kish zanë...

Rexha i Budakovës
me nandë varrë në shtat
erdhi gjallë në shpi
hypun n`tbardhin at!...

Kishte shpirt të fortë
për luftë ish betue,
të nantë varrët e trupit
s`mujten kund me rrëzue.

Te dy këta u vranë
në luftë me Turqi
jetën e flijuen
për nanën Shqipni...

Ma vonë e ma përpara
trimat s`u sosen kurrë
luftuen e ranë prore
për atdhe flamur...

Kanga s` e harroi
as Salih Shabanin
që e vrau te Prroni
atë Spirë Kapetanin...

Edhe sot e nesër
do të këndohet kanga
ma mirë në luftë me dalë
se me jetue nën pranga.

Ma mirë njiherë nana
me të qa me furkë në dorë
se me të pa e mjera
për ditë kah t`bajnë hor!

Ma mirë me të mbetë nusja
tue qa me krye në magje
se t`jetojë fatziu
pa nder, pa syfaqe!

Ma mirë t`hingëllojë kali
pa zot lidh për huni
se me mbetë gjallë i dekun
i rrahun mes katundi!...

Ma mirë t`kalbet molla
në raft ty tue të pritë
se sa me ndejtë si qyqe
për ditë me u koritë...

Le të këndojë martina,
pra mbi cep të krahut
le të shoqnojë bylbyli
tue këndue n`degë të ahut.

Le t`i shkojë anmikut
currel n`krye e n` bark
atëherë ta dijë tanë bota
se kush asht trim "kaçak"!

Le të dihet se s`shkon jeta
si qyqe, kërcu n` shtëpi
pa bukë e pa jetë t`lume,
pa diell, dritë - pa liri.

Le të dihet se liria
na duhet për çdo kohë
ajo n` erë të flladitë
dhe n`dimën të ngrohë.

Le të ushtojnë pra lugjet
e bjeshkët tona të gjana
atëherë do të thonë hallku
të lumtë baba e nana!

Kush qe ai ma i pari
që këtë darsëm nisi
ju shtoftë ora, fama
iu ndrit emni, fisi!

(Gjakovë, shtator 1951)

BETIMI

Bëj betimin
me shpirt e fjalë:
gjuhës së nanës
zot me i dalë!

Bëj betimin
me bindje të thellë:
vendin tim
me dashtë me k'kndellë!

Bëj betimin
që për jetë prore
me i dalë krah
shqipes arbnore!

Bëj betimin
që si parim
me pasë luftën
për bashkim!

Bëj betimin
që për atdhe
me dhanë jetën
si me le!

Bëj betimin
dhe s'prapem fare
mos me ba kurrë
punë me marre!

(Gjakovë, nëntor 1951)

POPULL MOS U NËNSHTRO

(në frymë të hallit)

O populli ynë, popull i ngratë
që po mbahesh me kore t`thatë

dhe pse ke mundësi me pasë ma shumë
si mos të ishe në robni me dhunë.

Po punon shumë, pak po fiton
se dikush tjetër po të gllabëron!

Të lanun, shkret, mos rrini o shokë
bini vetes mbrapa, mblidhuni tok!

A po shihni vëllazën se ku janë qitun
disa të padishëm, disa telallë të shitun.

S`po të bajnë hesap, s`ti njohin kreshnikët
e djemt tu po mbahen se me qenë të fikët.

Vendin bukanik po ta kthejnë në shkreti
shpirtin tand të lirë po ta kthejnë në robni!

Dhe ti s'po livrit për me pa shpëtim
vallë ku je, ç`të gjeti, o populli ynë trim!

Po ndahen burrat kudo nëpër botë
u munduen fituen, lirinë e gëzojnë sot!

Merrni mësim e shembull sa asht e mundun
idealin e shejtë kurrqysh s`ban me humbun!

Ndër ju flen trimnia, jini të zotët e pushkës,
mos duroni shtypje, mos i drueni luftës!

Mos iu tut anmikut ai s`ka zemër të gjanë
i dridhet dheu nër kambë me ta ndëgjue zanë!

E me ta pa pak forcën të mendjes e të grushtit
ka me marrë vetë ikën, ka me ra n`fund të pusit!

Atë po e mban gjallë veç jote padija
ai nuk asht i fortë, gjallë e mban djallëzia!

Djemt tu janë fajtorë që po rrinë t`nënshtuem
s` di a janë aq të padishëm a janë të mashtruem?!

Për nji seli të keqe dhe për me i hecë pak fjala
shqiptari i ngratë po fryhet si zhaba!

Rrëzon gurë në vëllanë, i ndihmon tjetërkuj
ves ky që s`asht për burra, për ne asht i huej.

Të parët tanë, dije, kurrë s' lanë trashëgim:
me përbuzë vetveten, me hedhë në greminë!

Rimëkëmbu o popull si forcë e bashkueme
shkollës mos iu ndaj, kësaj dritë t` prarueme!

(Gjakovë, nëntor 1951)

KËSHILLA TË BABAPLAKUT

(Në shenjë kujtimi të njëvjetorit të vdekjes së babës)

Babaplak, o i ndjeri, baba im:
trupin n`tokë, shpirtin në amshim
te ne s`lë sall fjalë kujtim,
por lë vepra dhe shumë ma tepër,
nëse mund t`i shkruajmë në letër!

Na i la dhe disa këshilla të dhenme
që u skaliten në mendjen teme:
për jetën luftë, për jetën det
për jetën pyll, për jetën jetë:

1.

Shëndeti asht mbi të gjitha në çdo kohë dhe vend
jo veç n` trup pa dhimbje, po shëndeti në mend!

Mësoni, rradaken me lye gjithë përmbrenda:
Hije të mirë lëshon veç lisi me rremba!
Jetëgjatësinë lisi e merr nga toka
nëse i ka të gjitha të vetat rrajë të forta...

Lis me rremba me rrajë të shëndosha
asht atdheu me plot vasha e djelmosha
që për ta, për shëndet, për ardhmeni
janë të gatshëm në mund me u shkri!...

2.

Në pyetje të vështira për punë të mëdha
mos ngurro, as mos shpejto me folë n`hava:
së pari pyet shpirtin e ndërgjegjen
e pastaj mundohu me e dhanë përgjegjen!

Ma mirë shpo veten me hej
se sa t`ndershmin, thue, ta rrej,
po të pandershmin, rrencat krypi,
rriqnat, morrat, pa mëshirë mbyti.

Mbyte të kegen pa u rritë hala
po e le ma vonë mund të gjëjë hata!
Mos bani si na që t`pabesit i besuem
dhe kështu veten shumë e randuem...

S`ka kurrkund aq të madhe të keqe
se kur vetveten e vë ndër leqe...
Kur të zë puna, mos mashtro veten,
po lufto ta gjesh veç të vërtetën...

Rrencin rreje, por t`ndershmin jo
me sy n`ballë na baltinë mos shko!

3.

Mësimi domosdo vyen për çdo njeri
nis në vegjëli deri në pleqni,
por i riu sa asht tue e rritë shtatin
veç kah mësimi ta lëshojë vrapin...

Të mësojë shumë, gjithçka të mësojë,
gjithçka në jetë që i thonë "përvojë"...
Të dijë mirë, pse thonë të vjetrit:
fjala e urtë çel dyert e hek`rit!

Fjalët maten, peshohen veprat
mbyten ujqit, gjuhen leprat!
Ndryshe - ndryshe mbushet pushka
s`asht si shpendi, si arusha!...

Fjalët dhe mësimi mund t` shkojnë kot
n` valët e jetës po s` dite not...

Fjalët peshohen, veprat maten
kështu mëshirëmadhi jep uratën...

4.

Para se të kërkosh të vërtetën
gjithmonë mundohu, njih vetveten
Me zemër kur të bëhet gjykimi
gjithmonë në mendje flë vendimi

Kajtja thonë e koritë burrin
pika - pykë, thonë, e shpon gurin
Për me qenë burri e me u përmendë
punëve të këqija m`u ikë me mend;

nuk ndëgjon lajka, lole s` bahet;
kur të teprohet dhe pitja s`hahet...

Lajkat janë ma zi se korbi
s` t`lanë me pa kah zihet kobi.
Lajkat, thonë, fort ta thyejnë qafën,
fjalët e kota ta shtojnë gafën,
dredh të nxjerrin shpinës-barkut
s`janë llaf ode, po t`sokakut.

Me lajka t`merret dheu nër kambë
të ban të kafshosh buzët me dhambë!

5.

Çka sjellë jeta në përditshmëni
asht fshehësi kurrëkush s`e di
pra çdo çast të keshë në dijeni
se mund të ndeshësh në befasi.

Të papriturat: të mira, të këqija
qoftë nga jashtë, qoftë nga brendia
kur të vijnë fare pa paralajmërim
gjithmonë priti me durim...

Me arsye qëndresa kalitet
burri i matun kurr s`koritet!

Me shortime e me shërbime tjera
bahen të buta pemët e egra...
Hiq pa shkollë, pa punë, pa mund
njeri të zot s` kam pa kurrkund.

Shkolla e jetës mbi të gjitha rri
ajo formohet brenda n`shoqni...

Vërtet, n`vetmi, n`kujtim lind kanga
po n`shoqni farkëtohet fama.

Pa shërbime, pa shembëlltyrë
asnjë punë s` bahet e mirë.

6.

Asht ma i miri trashëgim:
me marrë mësim e me dhanë mësim

Fat i madh asht në këtë botë
me të ra hise me pasë odë.

Odat tona na dhanë mësim:
n`histori të mos të ketë harrim
dhe të vijëzohen brez pas brezit
do vija të qarta të karakterit...

Janë do sharte që na i mësonte oda
"më fole", "të fola", "të lumtë goja":
"gjithmonë paçim", thotë, mendja e hollë:
"kend me ndëgjue, kujt me i folë"!

Muhabeti, dija rrin gjithmonë ngujue
nëse s`ka kush me i shkumb'llue...
Duhet lugjet - gjuhen kodrat,
me pak të rame s`gjëmojnë lodrat!

Mençurinë ta ndëgjjon bota
kur nuk i lenë të korrat dorëza,
por kur i fshin e i vë në hambar
atëherë njihesh bujk i mbarë!

Hem me fjalë hem me vepër të mirë
zë shumë miq dhe dashamirë!...

Me dhanë mësim e me marrë mësim
asht ma i shtrejti trashëgim!

7.

Përpiqu për vend për qiell e tokë
përpiqu për miq, vallazën e shokë...

Me njoftë vetveten, vërtet asht vështirë
me halle tua me u marrë asht mirë.

Ka njerëz që shohin ç`po ndodh në Azi
e s`shohin çka ka në të tynen shtëpi!

S`shohin e s`dijnë çka kanë më afër,
por qajnë Afrikën pse paska të varfën!?

S`e shohin robninë që n`shpirt, po i ndukë
s`e shohin të vetin pa veshë, pa bukë!?

O mjer ai njeri, nëse i thonë njeri,
që e mëson shpirtin të jetojë n`robni!

Nëse del kush me njoftë vetveten
atëherë pa vështirësi, thonë, njeh tanë jetën.

Pa njoftë vetveten dhe forcë pa i dhanë
atëherë s`t`vijne ndihmat nga katër anë.

Po s`qe i fortë, po s`pate trimni
kush s`ndihmon, as s`t` sheh me sy!...

8.

Lufta e jetës fitohet me shoqni,
bashkimi vërtet krijon fuqi...

Po fuqia s`asht si tymi me kashtë
shpesh ngreh mbarë, por ngreh dhe mbrapësht!...

Mençuri asht me ngreh mbarë si bota
sipas masës që të mëson vetë koha.

Kush e di ç`asht dhimbja e plagës
e di pse plaku i mbështetet shtagës;
e di se lulja para se t'vyshket lypshi
e di se pa mund e zor s`ndërtohet shtëpi;

e di se kokrra e sheh kokrrën e piqet,
e di se krymbi bashkë me drunin digjet;
e di pse thuhet "vakti kashtën ha"
e di pse thuhet mbau për toke, jo për hava!
Me u njoftë mirë bota asht mençuri
lules para se të vyshket i duhet shi...

9.

Lufta për gjuhë e atdhe të lirë
s`pushon kurrë dhepse asht e vështirë!

Gjuha e atdheu s`durojnë ngecje
po gjithmon duen zhvillim në ecje...

Asht gjynah mos me thanë hapun
gabon shumë kush s`e lyp hakun.

Asht gjynah mos me thanë qysh vynë
t`koritë shpinë pitja pa tlynë,
kur ke livadhe e i kosit vonë
jo pse s`mundesh, por pse priton;
që s`mban lopë e s`mban bagëti
kur për këtë ti ke mundësi!
Kur s`je i fortë, me mend puno:
ku ka ngatërresa rrugën leqo!
E di qyteti e di katundi,
qent e hanë atë që bien përfundi!

Trimni mbas lufte, urti mbas kuvendi:
hajmali n`ujë, s`janë kurrfarë sendi.

Çdo gja në kohën e vet piqet
çdo pemë hahet kur të ndriqet...

Kur të përllomesh uji t`ban paç
kur të hasmohesh ndaja asht ilaç.

Deri në fitore s` duhet me u ndalë
murtajen veç flaka, thonë, e kallë.

Me zjarm, me flakë hiqet murtaja
me dije kapen ma të naltat maja!

Zemra, mendja, kanga e trimit
gjithmonë ndritin n`ballë të kushtrimit!

Gjakovë, maj 1952

DETYRË E NDRITUR ME PËRGJEGJËSI

-në prag të maturës-

Si drita e diellit për lulet në pranverë
si riga e shiut për bimën në verë
ashtu është mësuesi, zot i të vetes punë
kur i selit filizat me durim pa dhunë.

Si engjëll fëmijëve u duket mësuesi i vërtetë
ngase i pajisë me dije, me armë të fortë për jetë...
Mësuesi duhet kujdes të madh me pasë
të ruhet që për të bukurën të mirën mos ta vrasë.

Për me u ba vepra e tij shumë ma e pëlqyeshme
duhet të ketë qendrim e sjellje të njerëzishme,
pra duhet ta punojë e ta gatuejë brumin si ka hije
që ai kështu të mbetet shembëll ardhmenie...

Mësuesi duhet ta njohë frymën e popullit të vet
me dashtë vendin, qiellin dhe gjuhën që ai e flet...
Mos me e kursye mundin për vendin ku ka le
Me u shkri për ideal: për komb, për atdhe!

(Gjakovë, qershor 1952)

NANO PRITE DJALIN ...

Nano, prite djalin
dhe dil hiqe mallin
që pate ndaj tij
sa s`e kishe n`shpi;

Shih si e nalton ballin,
di ta kuptojë hallin
ja si shkrihet n`dashuni,
që po kthehet n`shpi...

Vetë e linde, vetë e rrite
e ndër shokë ti vetë e qite
me krahë nane i përkëdhelë
gonxhe ish lule u çel...

Tash me shkollë i armatosun
do të jetë edhe më i vendosun
me luftue, nanë, të keqen tonë
që na shtyp e na robnon!

Me luftue, nanë, mbrapambetjen
me ta thanë gjithmonë t`vërtetën
në rrugë të dritës me i çelë sytë
me njoftë ma mirë hasmin e ndytë!?

(Gjakovë, 11.VII.1952)

TRIMOSHI DHE SHQIPONJA

(bashkëbisedë)

T

Moj Shqiponja, legjendë hirore,
ba prej brumi: rrajë fierore,
kallza t`lashta, freskim bjeshke,
xixa stralli me erë eshke...
Flutras hyne n`palcë t'Flamurit,
kastriote e Skërnderburrit
që gjallon n`ftyra stolinash
n'veshë darsmorësh, valle trimash...
pse qëndron sot keq, pa gaz
pse t`asht mbushë vetja maraz?!

SH

-M`asht këputë shpirti, po m'plasë zemra
E keqja e jashtit, m`asht futë mbrenda
Dranga e motit tmerr, hata
pik'pesë zogjt m'i ka shpërnda
na ka prishë të përbashktën votër,
cak: mos të njihen vëlla e motër!

T

Moj shenjmira e shqiptarisë,
moj fushëkuqe, futë e zisë
me dy krena, sy dyparë
me një zemër t'madhe t'bardhë;
sqepa dy dhe kthetra t'mprehta
mbretneshëmadhe ndër këta kreshta...
pse kushtrimin nuk po e lëshon:
me vra t'keqen që t'pllakon?!

SH

-Nuk po di si me marrë veten
druej ma keq shpresat na meken
druej se pësojmë edhe ma shumë
pres t'fashitet këllia në lumë.

T

Moj shqiponja dykrenore,
derisa të kemi frymë arbnore,
nata jonë s`do të jetë pa yje
as pa shqipe tonat pyje.

Për flut`rushë s` mbyllet dot qielli
sa me shoshë a zihet dielli;
herëdokurë në cakdëshirë
kanë me u tubë shqiponjat shlirë!

SH

-Të lumtë goja, lumti vëlla,
fjala e mirë peshën e ka
po 'i herë lama m'asht zdërvajë
m'asht mbushë luga helm e vaj!

T

Thonë çdo sëmundje, çdo shëmtim
ka ilaç, ka dërë, shërim.

SH

Plagë e madhe, djegsim shumë
Me marrë veten ka do punë!

T

-Po gjithmonë duhet hedhë hapin
atë të mbarin jo të praptin
puna e parë që lypset sot:
bashkim beset jetë e mot!

SH

-Mirë e ka po s'mund t`le anash:
ecjen mbarë me rrugë kurbanash;
rruga e zorshme lyp viktima;
ku ka breshën ka shkrepitima...

T

Mendja e t'urtit e vret tutën
pushka e të drejtit e ndal luftën
kurrnjihërë nuk meket shpresa
për liri kur t`lidhet besa!

SH

E bren gurin me lëmim litari
nuk le nyjë pa zgjidhë bestari,
po pa përpjekje s`ndihmon ora
pa luejtë kamba, pa luejtë dora!

T

Prej do deg'sh vjen forca e Drinit:
mendja e të dishmit, pushka e trimit...
çelësa të forcës në ballë të furtunës
pesha e mallit, arti i punës...

SH e T (bashkërisht):
Të përbashkuem o bijt e shqipes
mos t'i bajmë ma aman frikës,
me shenjmirën e krenarisë
t'ia kthejmë lavdin Shqiptarisë.

(Reçan, 20 gusht 1952)

TRYEZA E LËNDËS

Parathënie

1. Kangë kapuçash
2. Kur këndojnë çikat?!...
3. Koha asht ar
4. Besimet e kota
5. Malli ndaj vendlindjes
6. Oj Kosovë
7. Martirit të humbun (elegji)
8. Çaste zhgënjimi për nanën tonë
9. Luleshpresë
10. Pemëmadhes sonë
11. Formimi i kooperativës katundare
12. Zhgënjimi i bujkut ish-partizan
13. Zogut të hallit
14. Brisku i rizbuluar
15. Një përrallëz fjalëmbasdarke
16. Prisi i ri i tufës së vjetër
17. Zani i trimnisë (kushtrim)
18. Betimi
19. Popull mos u mashtro
20. Këshilla të Babaplakut
21. Detyrë e ndritun e me përgjegjësi
22. Nano, prite djalin
23. Trimoshi e shqiponja (bashkëbisedë)